

## Programi i studimit

Akademia Olimpikë e Kosovës ofron programe studimi të nivelit të pestë për programin “Trajner Sportiv”. Pas përfundimit të programit të studimit Akademia Olimpikë e Kosovës lëshon:

a) Certifikatë Kombëtare Profesionale.

Kohëzgjatja e programit të studimit të nivelit të pestë “Trajner Sportiv”, me kohë të plotë është vetëm një vit dhe për të fituar një certifikatë nga Akademia Olimpikë e Kosovës, kandidati duhet të ketë grumbulluar 60 ECVET kredi.

Kohëzgjatja maksimale e studimeve e lejuar është sa dyfishi i viteve të studimit. Nëse kandidati nuk i përfundon studimet brenda këtij afati, e humb të drejtën e studimeve.

Plan programi për një vit studimi është:

Semestri I					
		Orë- Javë			
Nr	Lëndët	L	U	ECVET	
1	Anatomi, Fiziologji e Njeriut	2	2	5	
2	Psikologjia Sportive	2	0	4	
3	Pedagogjia në Sport	2	1	5	
4	Menaxhimi në Sport	2	0	4	
5	Biomekanikë Sportive	2	1	4	
6	Metodologjia e Metodave të punës së trajnerit në Sport	2	2	5	
7	Matjet, Testimet në Sport	2	1	3	
Semestri II					
		Orë- Javë			
Nr	Lëndët	L	U	ECVET	
1	Metodat e Hulumtimit në Sport	2	2	5	
2	Teoria dhe Metodologjia e Trainingut Sportiv	2	1	5	
3	Nutricioni në Sport	2	0	4	
4	Edukimi Olimpik	2	0	3	

6	Edukimi Fizik Special	2	1	3	
7	Intership - Klubi Sportiv	/	100	5	
8	Prezantim- Portfolio			5	

*Sqarim: Numri total i kredive (ECVET) të akumuluarra për një vit është 60 ECVET - kredi. Nga 12 lëndët obligative fitohen gjithsej 50 ECVET, nga lënda në semestrin e dytë praktikë në klubin sportive kandidati/tja do të fitojë gjithsej 5 ECVET - kredi. Pas përfundimit me sukses të prezantimit final- Portofolie, kandidati/tja do të grumbul/ojë 5 ECVET - kredi.*

## Kreditë

Një kredi formimi i arsimit dhe aftësisimit profesional për nivelin e pestë “Trajner Sportiv”, i korrespondojnë 20 orë mësimore pune të kandidatit (1 orë mësimore llogaritet 45 minuta).

Sasia mesatare e punës së kryer nga kandidati gjatë një viti studimesh me kohë të plotë për nivelin e pestë “Trajner Sportiv”, është 1200 orë mësimore (60 kredi ECVET), që përfshijnë orë në auditor (ligjërata, ushtrime praktike) dhe orë pune të pavarur.

Kandidati, vetëm në rastin e një vlerësimi pozitiv në verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tij, fiton kreditë korresponduese për çdo veprimtari formuese si: lëndë, praktikë, protfolio, etj.

## **Certifikatë Kombëtare Profesionale**

Kandidatët mund ta fitojnë këtë kualifikim vetëm nëse ndjekë trajnimin sipas moduleve dhe kalon me sukses provimet e lëndëve teorike dhe ushtrimet praktike. Bazuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve, certifikatat apo diplomat e fituara për këtë nivel të arsimit, janë të nivelit pesë të kualifikimeve, të cilat shërbejnë për të dalë në treg të punës, ose për t’u rikualifikuar për punë të caktuar.

### **“Trajneri Sportiv” mund të punojë në vendet e punës si në vijim:**

1. Shoqata sportive;
2. Klubet sportive vendore;
3. Federatat sportive vendore;
4. Klube dhe federata ndërkombëtare.

Kandidati i diplomuar në programin “Trajner Sportiv”, është ekspert në trajnime sportive të përgjithshme krahas një sporti specifik. Kjo njohuri i mundëson të diplomuarit të planifikojë dhe zbatojë programe stërvitore në sportin e tyre specifik në të gjitha kategoritë e moshave dhe të gjitha nivelet e performancës sportive.